



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P- 90
Prishtinë, më 20 nëntor 2009

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 20 NËNTOR 2009**

Seancën e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit, ndërsa bashkëkryesues ishte Eqrem Kryeziu, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e seancës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në fillim të seancës, deputeti Fatmir Rexhepi kërkoi nga kryetari i Kuvendit që të paraqet një informatë lidhur me relacionet e fundit brenda koalicionit qeverisës.

Kryetari tha se informatë mund të kërkohet nga subjektet politike, që kanë formuar koalicionit qeverisës, ndërsa Kuvendi t'i zhvillojë punimet sipas agjendës së miratuar.

Deputeti Fatmir Rexhepi insistoi që para se të fillohet me rendin e ditës, deputetët të informohen me atë se çka është diskutuar lidhur me koalicion qeverisës.

Pas situatës së krijuar, Kryetar dha pauzë 30 minuta.

Pas pauzës, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, propozoi që seanca e sotme të shtyhet për të hënë, më 23 nëntor 2009.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, paraqiti mocion për shtyrjen e seancës së sotme, me arsyetimin se deputetët nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për shqyrtimin e Projektbuxhetit të vendit për vitin 2010.

Kryetari hodhi në votim mocionin e paraqitur nga Lutfi Haziri.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi mocionin për shtyrjen e seancës për 23 nëntor 2009.

E hënë, më 23 nëntor 2009, ora 10:00

Vazhdimi i seancës plenare

Seancën plenare e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 82 deputetë.

Kryetari tha se seanca e sotme i zhvillon punimet sipas rendit të ditës të miratuar më parë.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010

Kryetari ftoi Kryeministrin e Republikës së Kosovës, që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektbuxhetin për vitin 2010.

Hashim Thaçi, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, paraqiti Projektbuxhetin për vitin 2010, të përgatitur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe i harmonizuar me të gjitha agjencitë buxhtore.

Në vazhdim, ai tha se ky është projektbuxhet i zhvillimit dhe i integritetit për Kosovën, i orientuar drejt politikave zhvillimore për të gjithë qytetarët e Kosovës, ku ekonomia parashihet të ketë rritje për pesë (5) %.

Buxheti i propozuar për vitin 2010 parashihet të jetë 1.461.000.000 euro, krahasuar me vitin 2009 ka një rritje prej 6% e cila vjen si rezultat i rritjes së bazës tatimore, vuri në pah Kryeministri.

Në vazhdim tha se në fushën e shëndetësisë është rritur fondi për listën esenciale të barnave dhe për pagat e punëtorëve shëndetësorë për punën jashtë orarit. Ngjitje në paga do të ketë edhe për Policinë e Kosovës, po ashtu është rritur mbështetja maksimale për Universitetin e Prishtinës.

Kryeministri potencoi se me Projektbuxhetin për vitin 2010, shpenzimet kapitale parashihet të arrijnë në 400 milionë euro dhe përmendi gjithashtu ndarjen e pjesshme të mjeteve financiare për autostradën Vërmicë – Merdar. Qeveria vazhdon financimin e

blerjes së objekteve për ambasadat e reja të Republikës së Kosovës, për Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës, etj, tha ai. Po ashtu tha se në projektimin e këtij projektbuxheti kemi pasur mbështetjen e partnerëve tanë, si nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Komisioni Evropian.

Në fund, ai tha se ky sukses është arritur falë instalimit të qeverisjes së mirë, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Kryetari në vazhdim ftoi ministrin e Ekonomisë dhe Financave, që para deputetëve të arsyetojë Projektbuxhetin për vitin 2010.

Ahmet Shala tha se Projektbuxheti për vitin 2010, i paraqitur sot për shqyrtim është rezultat i përgatitjeve që kanë zgjatur me muaj të tërë. Struktura e këtij projektligji konsiston në rritjen ekonomike, qeverisjen e mirë dhe krijimin e stabilitetit insitucional. Ai tha se me këtë projektbuxhet të hyrat e rregullta janë 8% më të mëdha se në vitin 2009. Më tej, tha se jemi në fazën finale të pajisjes së bizneseve me numrat fiskal dhe vendosjes së arkave fiskale, e cila gjë do të japë rezultate në vitin 2010.

Ministri vuri në pah edhe faktin se Projektbuxheti krijon një balansë ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve, duke konstatuar se kemi një rezervë fiskale në shumën prej 200 milionë euro. Edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar pas negociatave të shumta që kemi pasur, është ndarë i kënaqur me strukturën e buxhetit të propozuar, tha ai.

Në vazhdim ministri paraqiti në hollësi kuotat ose rritjet buxhetore në përqindje, të propozuara për ministrinë e linjës, disa nga të cilat janë:

Spektori i Transportit parashihet të ketë 112 milionë e 500 mijë euro, 50 milionë euro si subvencion për spektorin e energjisë, për Universitetin e Prizrenit 2.1 milionë, për spektorin e shëndetësisë ka rritje për 8.4%, për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka rritje për 8.6%, për spektorin e sigurisë dhe drejtësisë 14.2%, për spektorin e bujqësisë rritja vetëm në sobvencione është 300% më e lartë se në vitin 2009, më saktësisht ajo arrin kuotën prej 4.5 milionë euro, për Ministrinë e Punëve të Jashtme buxheti i paraparë për vitin 2010 do të jetë 23.3 milion, euro, granti qeveritar për komuna është paraparë të arrijë 284 milion euro, për Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtjen e Mjedisit buxheti i paraparë do të jetë 8 milion euro, Ministria për Komunitet dhe Kthim do të ketë buxhetin prej 8, 7 milion euro.

Ministri paraqiti hollësi të tjera rreth dedikimeve buxhetore për të gjitha dikasteret, të cilat janë dhënë në transkript i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Në fund ai i ftoi deputetët ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Në vazhdim **Kryetari** tha se, pasi që kemi një mumër shumë të madh të deputetëve të paraqitur për diskutim, propozoi që shefat e grupeve parlamentare të kenë në dispozicion për diskutim 10 minuta, kurse deputetët 5 minuta.

Deputetët u pajtuan që ky propozim i Kryetarit të hidhet në votim.

Për këtë propozim 53 deputetë votuan për, kurse 20 kundër, abstenime nuk pati.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në

emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sllavisha Petkoviç si dhe deputetët: Gjylnaze Syla, Zylfije Hundozi, Donika Kadaj-Bujupi, Driton Tali, Sabri Hamiti, Numan Baliç, Ismet Beqiri, Ibrahim Gashi, Myzejene Selmani, Fatmir Rexhepi, Agim Veliu, Suzana Novobërdaliu, Zef Morina, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Naser Rugova, Enis Kervan, Ramadan Avdiu, Qamile Morina, Sadik Idriz, Mimoza Ahmetaj, Rita Hajzeraj, Bahri Hyseni, Myrvete Pantina, Ali Lajçi, Xhevdet Neziraj, Jakup Krasniqi, Drita Maliqi, Fehmi Mujota, Synavere Rysha, Hashim Thaçi, Hafize Hajdini, Kaqusha Jashari, Danush Ademi, Arsim Bajrami, Gani Koci, Edita Tahiri, Heset Cakolli, Vezira Emrush, Rustem Mustafa, Gani Buqinca, Ismet Beqiri, Shkumbin Demaliaj, Hydajet Hyseni, Mark Krasniqi, Lutfi Haziri, Sala Berisha-Shala, Adem Salihaj, Adem Grabovci, Nurishahe Hulaj, Nekibe Kelmendi, Hajdin Abazi, Drita Kadriu dhe ministri Ahmet Shala.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër-----14,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet, në parim, Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.
2. Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa si komision funksional dhe raportues, që ta shqyrtojë Projektligjin dhe të përgatisë raportin për seancë.
3. Komisionet e përhershme dhe funksionale mund ta shqyrtojnë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, nga aspekti i fushëveprimet të tyre, dhe amendamentet eventuale t’ia paraqesin Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 17:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale**